



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:100465

Datë: 11.07.2019

Numri i dokumentit: 00403898

PKR. nr. 28/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti për Krime të Rënda gjyqtari Nikollë Komani, kryetar i trupit gjykues, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në lëndën penale kundër të akuzuarit E.I. nga Gjakova për shkak të veprës penale posedimi paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I nr. 42/2019 të datës 16.05.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit të dytë, më datë 08.07.2019, në prezencën e prokurorit Ali Uka, të akuzuarit E.I. dhe mbrojtësit të tij B.C. avokat në Pejë, me datë 10.07.2019 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 11.07.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **E.I.**, i biri i S. dhe L., e gjinisë M., data e lindjes..., në Gjakovë, ku edhe tani banon, i pamartuar, ka të kryer pesë klasë të shkollës fillore, punëtor krahu, i gjendjes së varfër ekonomike, numër personal ..., ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse pa autorizim ka poseduar substancë narkotike e cila me ligj është shpallur si narkotikë, në atë mënyrë që ditën kritike me datë 02.05.2019 rreth orës 10:20/h DHTN në Gjakovë, duke vepruar në bazë të një urdhri verbal të lëshuar nga ana e Prokurorisë e të konfirmuar nga ana e Gjykatës nën PN.KR.nr. 8/19 me datë 02.05.2019, ka bërë kontrollin e shtëpisë dhe objekteve tjera përcjellëse të pandehurit E.I., në Gjakovë, ashtu që nga kontrolli i kryer është gjetur dhe sekuestruar substancë narkotike në formë bari e që nga raporti i analizës së narkotikëve e përpiluar nga hetuesit R.P. me datë 10.05.2019 ka rezultuar të jetë e llojit marihuanë më peshë prej 9.54 gram, një mulli të vogël për bluarjen e narkotikut si dhe një pako rizlla.

- **me çka ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.**

Gjykata në bazë të nenit 6, 7, 17, 38, 39, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 269 par. 1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, e:

G J Y K O N

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër tjetër penale, si dhe **Dënim** me gjobë në shumën prej 600,00 € (gjashtëqind euro), të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në afatin prej 1 (një) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti do ti zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 ditëve, duke ja llogaritur 20,00 € për një ditë burgimi.

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 50,00 €, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50,00 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konfiskohen substancat narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 9.54 gram, mulliri për bluarjen e narkotikut si dhe një pako rizlla, si objekte të kryerjes së veprës penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda me aktakuzën PP/I nr. 42/2019 të datës 16.05.2019, ka akuzuar E.I. nga Gjakova, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 2 të KPRK-së.

Prokurori Ali Uka në shqyrtimin fillestar ka theksuar se me rastin e kualifikimit të veprës penale është bërë një lëshim teknik ku është shënuar paragrafi 2 i nenit 267 të KPRK-së, dhe kualifikimi i veprës penale duhet të jetë neni 267 par. 1 të KPRK-së. Gjatë shqyrtimit të dytë pasi mbrojtësi i të akuzuarit ka parashtruar kundërshtimin e provave ka deklaruar se kundërshtimin e provave dhe aktakuzës së parashtruar nga ana e mbrojtjes e kanë vlerësuar dhe kanë ardhur në përfundim se nga deklarata e dëshmitarit Q.L., si dhe ballafaqimi i bërë me të akuzuarin E.I., ka rezultuar se nuk është arritur që të provohet se dëshmitarit Q.L. ti ketë shitur substancë narkotike dhe sikur dëshmitari të ketë deklaruar se ka blerë substanca narkotike nga i akuzuari, sipas dispozitave të KPP-së, me një dëshmi nuk mund të mbështetet gjykata, e duke qenë se nuk ka edhe prova tjera të cilat provojnë se i akuzuari E.I. është marrë me shitblerjen e substancave narkotike, ka bërë ri-cilësimin e veprës penale nga vepra penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, në veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, e që si rrjedhojë e këtij ri-cilësimi nga dispozitivi i aktakuzës nga fjalia e parë “hiqen fjalët me qëllim shitje”, gjera pjesa tjetër e dispozitivit mbetet e njëjtë. Pasi i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale të ri-kualifikuar, prokurori ka deklaruar se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë dhe janë të bindur se ky pranim i fajësisë është bërë me vullnet, pa presion, i akuzuari i ka kuptuar pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë, si dhe pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në provat e siguruara gjatë procedurës së hetimeve e të bashkangjitura aktakuzës. Ka propozuar se me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe ka propozuar që të

shqiptohet dënimi plotësues konfiskimi i substancave narkotike në sasi prej 9,54 gram e llojit marihuanë.

Mbrojtësi i të akuzuarit E.I., avokati B.C., ka deklaruar se pasi i akuzuari e ka pranuar fajësinë në mënyrë të vullnetshme si mbrojtës pajtohet me pranimin e fajësisë pasi të mbrojturit të tij ja ka sqaruar të gjitha benifitet dhe pasojat që dalin nga pranimi i fajësisë. Ka shtuar se duke pasur parasysh që i akuzuari asnjëherë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, është hera e parë dhe ka premtuar se më nuk do të përdori substanca narkotike, është penduar, si dhe duke marrë për bazë arsimimin e tij, i propozon gjykatës që ti shqiptoj një dënim sa më të butë të paraparë me ligj.

I akuzuari E.I. ka deklaruar se e ka të qartë rikualifikimin e veprës penale të bërë nga ana e prokurorit. Ka shtuar se është e vërtetë që policia ja kanë gjetur substancën narkotike, e ka pasur në një vend grumbull, nuk ka qenë i paketuar, e ka pasur për përdorim personal, pasi e konsumon substancën narkotike, ndërsa duke u deklaruar lidhur me fajësinë ka theksuar se e pranon në tërësi fajësinë.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e fajësisë e ka bërë në baza vullnetare, pa presion, pas konsultimeve paraprake me mbrojtësin e tij, gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në provat e bashkëngjitura aktakuzës si raporti i analizës së narkotikëve i datës 10.05.2019, dëftesa mbi konfiskimin pronës dhe atë substancave narkotike, mullirit dhe një pako rizlla e datës 02.05.2019, raporti i oficerit policor i datës 02.05.2019, procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave i datës 02.05.2019, foto-albumi, si dhe nga vetë pranimi i fajësisë së bërë nga i akuzuari, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par. 4 të KPP-së dhe shqyrtimin e ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojit të tij, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale në mënyrë, kohën dhe vendin të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit nuk ka gjetur rrethana rënduese. Ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marrë parasysh pranimin e fajësisë, pendimin e tij, sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit, jo dënueshmerinë e tij të mëparshëm e të cilat rrethana lehtësuese kanë ndikuar që të akuzuarit ti shqiptohet dënimi i kushtëzuar dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër tjetër penale, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 600,00 €, me bindjen e plotë se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së.

Vendimi për konfiskimin e substancave narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 9.54 gram, mullirit për bluarje si dhe një pako rizlla është marrë bazuar në nenin 269 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 50,00 €, është marrë bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2, nën par. 2.6 të KPP-së, si dhe shumën prej 50,00 € për kompensimin e viktimave të krimit është marrë bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit numër 05/L-036.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
PKR. nr. 28/19 datë 10.07.2019

Sekretarja juridike
Mandushe Doli

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,
Nikollë Komani

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afatin prej 15 ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.